



Trupi Koordinues i Qeverisë së Republikës së Sërbisë për komunat Preshevë, Bujanoc  
dhe Medvegjë

## **Informacione mbi aktivitetet e Trupit Koordinues**

(janar–dhjetor 2013)

Shërbimi i Trupit Koordinues i Qeverisë së Republikës së Serbisë për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegje raporton mbi aktivitetet vjetore të realizuara në vitin 2013. Në periudhën e kaluar janë shënuar suksese dhe rezultate të rëndësishme:

**a) Në sferën e infrastrukturës dhe ekonomisë** – Në projektet infrastrukturore në tri komunat Shërbimi i Trupit Koordinues në vitin 2013 ka investuar 176.039.776,51 dinarë. Në komunën e Preshevës janë investuar 64.985.704,85 dinarë për rekonstruimin e rrugëve në fshatin Tërnavë, Corrotic dhe Bukuroc, ndërtimin e trotuareve dhe auto parkingut në lagjen Qemal Shehu, rekonstruimin dhe ndërtimin e rrugës në fshatin Norçë dhe Rahovicë, rekonstruimin e rrugës në fshatin Shoshaj të Epërme dhe Poshtme dhe Miratoc. Është riparuar rrjeti i kanalizimit dhe është ndërtuar një transformatorë. Në infrastrukturë të komunës së Bujanocit janë investuar 83.389.571,66 dinarë. Me këto mjete është asfaltuar rruga regjionale Tërnoc – Breznicë, riparuar rruga në fshatin Klinoc, është asfaltuar një lagje në fshatin Karadnik, është bërë rekonstruimi i rrugëve në lagjet e fshatit Rakoc, Levosojë dhe Llopardincë dhe është riparuar lagja e Vardarit në Bujanoc. Në komunën e Medvegjës, në sferën e infrastrukturës janë investuar 27.664.500,00 dinarë për sanimin e zonës së këmbësorëve, riparimin e kanalizimit, lidhjes së ujit dhe sanimin e ndriçimit të rrugëve.

Me qëllim të fuqizimit të ekonomisë dhe nxitjes së zhvillimit ekonomik, janë ndarë 60 milion dinarë mjete të pakthyeshme për ndërmarrësit e tri komunave.

Trupi Koordinues si vijim të aktiviteteve për nxitjen e zhvillimit ekonomik në komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegje ka organizuar më 25 prill të vitit 2013 Panairin e parë të potencialeve investive. Në organizimin e Panairit përveq Trupit Koordinues kanë marrë pjesë edhe Oda Ekonomike e Serbisë, përfaqësuesit e komunave dhe Zyrat për zhvillim ekonomik lokal të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës.

Nga fillimi i vitit 2013, Trupi Koordinues është angazhuar në realizimin e aktiviteteve për ringjalljen e ndërmarrjes shoqërore “Gumoplastika”, e njohur si gjigande e dikurshme ekonomike në komunën e Bujanocit. “Gumoplastika” është themeluar në vitin 1959 dhe mirret me përpunimin e plastikës, gomës, metalit dhe këpucave. Mbi këtë veprimtari është iniciuar procesi i falimentimit në vitin 1998. Me përkushtëshmërin e përbashkët të Qeverisë së Republikës Serbisë dhe Trupit Koordinues, “Gumoplastika” pas 15 vitesh ka dal nga procesi i falimentimit dhe ka filluar një epokë të re të veprimit si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

Trupi Koordinues në bashkëpunim me përfaqësuesit e komunës së Bujanocit dhe Qeverisë së Republikës Serbisë do të gjejë investitorë të huaj në mënyrë që të ringjallet prodhimi i kësaj ndërmarrje shoqërore.

**6) Në sferën e integrimeve** – Me përkrahjen e ambasadës së Britanisë së Madhe, Shërbimi i trupit Koordinues edhe këtë vitë ka organizuar pa pagesë “Shkollën e gjuhës serbe për të rinjtë e nacionalitetit shqiptarë nga komuna e Bujanocit dhe Preshevës”.

Në zyrat e Shërbimit të trupit Koordinues në Beograd, praktikantët nga bashkësia shqiptare arrijn njohuri të rëndësishme. Duke iu faliminderuar “Programit për praktikant” të Zyrës për të drejtat e njeriut dhe pakicave, dy praktikant të cilit në ciklin e kaluar kanë kryer me sukses programin, punojn në Zyrën e Shërbimit të trupit Koordinues në Beograd. Përveq dy praktikantëve, në këtë moment në zyre në Beograd janë edhe tre persona nga bashkësia shqiptare të cilët punojn.

**b) Në sferën e politikës** – Qeveria e Republikës së Serbisë ka marrë Vendim me të cilin ka aprovuar Raportin nga mbledhja e kryetarit të Trupit Koordinues dhe përfaqësuesve të partive politike shqiptare. Në bisedime marrin pjesë 13 ministri, ndërsa Trupi Koordinues e bënë koordinimin e takimeve.

**r) Në sferën e arsimit** –Për 1000 nxënës fillorist të tri komunave janë siguruar çanta shkollore dhe paisjet, për çka janë ndarë 804.602,40 dinarë.

Në bashkëpunim me Ministrinë e arsimit dhe Këshillin nacional të Shqiptarëve, janë siguruar 88 tekste shkollore dhe fletore pune për nxënësit e shkollave fillore të cilët ndjekin mësimin në gjuhën shqipe dhe dy tekste për parashkollorët. Shërbimi i trupit Koordinues ndanë bursa për gjeneratën e tretë të rinjëve nga Bujanoci dhe Presheva të cilët studiojnë në fakultetet e Univerzitetit të Novi Sadit. Janë ndarë 285 bursa për nxënësit e shkollave të mesme të tri komunave.

Gjenerata e tretë e studentëve është regjistruar në paralelen e fakultetit Ekonomik nga Subotica në Bujanoc. Për nevojat e ndërtimit të objektit, Shërbimi i trupit Koordinues ka financuar përpilimin e projektit urbanistikë dhe atij final.

**ɗ) Në sferën e mbrojtjes shëndetsore dhe sociale** – Ka filluar faza e dytë e ndërtimit të maternitetit jashtëspitalor në Preshevë dhe është siguruar shumica e paisjeve të nevojshme për funksionim të këtij institucioni. Ministresha e shëndetësisë Slavica Gjukiq Dejanoviq ka vizituar ndërtesën e maternitetit dhe ka treguar interesimin e Ministrisë së shëndetësisë që të i ndihmojë funksionimit të këtij institucioni.

Nga rezervat buxhetore janë siguruar mjetet për sanimin e dëmit nga vërshimet për shtëpitë në komunat e Preshevës dhe Bujanocit.

**h) Në mardhëniet ndërkombëtare** – Shërbimi i trupit Koordinues ka realizuar bashkëpunim të jashtëzakonshëm me partnerët ndërkombëtarë: Delegacioni i Unionit European në Republikën e Sërbisë, ambasada e Britanisë së Madhe, ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Zyrja e Komesarit të Lartë për pakica nacionale, Misioni i OSBE-së në Republikën e Sërbisë, USAID, programet EU Progres dhe PBILD dhe shumë të tjerë. Kryetari Zoran Stankoviq është takuar me ambasadorin e SHBA-së, Britanisë së Madhe, Italisë, Japonisë, Suedisë, Gjermanisë, Norvegjisë, Austrisë, Turqisë, Shqipërisë, Zvicrës dhe Greqisë. Ai gjithashtu është takuar me përfaqësuesit e OSBE-së, përfaqësuesit e Delegacionit të UE-së në Sërbi dhe përfaqësuesit e Zyrës së komesarit të lartë për pakica nacionale.

**e) Në komunikim me publikun** – Në fillim të vitit, kryetari i Trupit Koordinues profesor Zoran Stankoviq u është drejtuar qytetarëve të tri komunave me letër nëpërmjet së cilës, në gjuhën e tyre amtare, i ka njoftuar me aktivitetet dhe rezultatet e këtij organi të qeverisë. Shërbimi i trupit Koordinues vazhdimisht njofton opinionin rreth punës së sajë duke publikuar raporte dhe tekste në faqën e internetit ([www.kt.gov.rs](http://www.kt.gov.rs)), dërgon raporte të punës Qeverisë së Republikës Sërbisë, mediave dhe partnerëve ndërkombëtarë.

**Aktivitetet kryesore të Shërbimit të trupit Koordinues në vitin 2013 të prezentuara në mënyrë kronologjike:**



- **Vizita e komesarit të lartë për pakica nacionale** –

Komesari i lartë për pakica nacionale Knut Vollebek në janarë të ka qëndruar në Bujanoc dhe është takuar me kryetarin e Trupit Koordinues profesorin Zoran Stankoviq. Profesori Stankoviq dhe E.T. Vollebek kanë biseduar rreth hapave të ardhshëm për avancimin e arsimit të lartë në jug të Sërbisë. Sëbashku me kryetarin e komunës së Bujanocit dhe dekanin e fakultetit Ekonomik, ambasadori Vollebek dhe profesori Stankoviq kanë vizituar lokacionin në të cilën është planifikuar ndërtimi i objektit për paralelen e fakultetit Ekonomik. Atëher është prezentuar edhe projekti kryesor i ndërtesës të cilin e ka financuar Shërbimi i trupit

Koordinues. Ambasadori Vollebek fuqishëm ka mbështetur projektin dhe ka potencuar që kjo iniciativë paraqet shembullin e bashkëpunimit të mirë ndërmjet pushtetit lokal dhe atij qëndrorë.

- **Bursat për studime në Novi Sad** –Për tri vite me radhë, Shërbimi i trupit Koordinues ndanë bursa për të rinjët nga Bujanoci dhe Presheva të cilët dëshirojnë të studiojnë në fakultetet e Univerzitetit të Novi Sadit. Me këtë program nxiten të rinjët nga jugu i Sërbisë që në vendin e tyre të kryejn shkollimin e lartë. 12, nga gjithsej 52 kandidatë, kanë fituar bursat. Në mënyrë që më lehtë të i nënshtrohen provimit pranues, për kandidatët për të cilët gjuha serbe nuk është gjuhë amëtare



është organizuar kursi i gjuhës serbe në periudhë tremujore. Kandidatët e zgjedhur kanë kaluar provimin pranues dha janë bërë studentë të fakultetit të Bujqësisë, të shkencave natyrore-matematikore, Filozofik, Mjeksisë dhe fakultetit të shkencave teknike. Ky është viti i parë që të drejtën për bursë e ka realizuar edhe një kandidat nga bashkësia rome. Bursën e Shërbimit të trupit Koordinues deri më tani e kanë fituar 32 student nga këto dy komuna. Ndarja e bursave të rinjëve për të

studiuar në Novi Sadin multietnik do të kontribuoj, jo vetëm në përmirsimin mardhënies ndëretnike në jug të Sërbisë, por edhe në avancimin e tyre profesional. Besojmë që këta të rinjë, pas përfundimit të studimeve, do të kontribuojnë në avancimin e rrethit ku jetojnë dhe në zhvillimin e komunave të tyre.

- **Vizita e ministreshës Verica Kallanoviç në Preshevë** – Shërbimi i trupit Koordinues ka organizuar vizitën e ministreshës Verica Kallanoviç komunës së Preshevës, ku ministresha ka marr pjesë në tribinën e kushtuar zhvillimit ekonomik dhe regional të tri komunave në jug të Sërbisë. Ministresha ka biseduar me kryetarin e komunës së Preshevës dhe përfaqësuesit e Trupit Koordinues rreth projekteve infrastrukturore të kësaj komune dhe potencialeve për ndërtimin e zonës industrial.

- **Ndarja e mjeteve në konkursin e Shërbimit të trupit Koordinues** – Në mars është shpallur konkursi për realizimin e projekteve të shoqatave qytetare. Komisionin për përzgjedhjen e projekteve e kanë përbërë nga një përfaqësues i secilës komune dhe përfaqësuesit e Shërbimit të trupit Koordinues. Në konkurs janë paraqitur 18 organizata ndërsa mjetet prej 797.500,00 dinarëve i kanë përfituar dy organizata nga Bujanoci.

Janë finansuar projekte nëpërmjet të cilave është avancuar zhvillimi arsimor në jug të Sërbisë. Në fakt, 279 nxënës, shumica e tyre të nacionalitetit romë, nga klasa e pestë deri në klasën e tetë të shkollës fillore “Branko Radiçeviq” në Bujanoc janë paisur me tekste pa pagesë. Rreth 200 nxënës nga bashkësia rome, nxënës të shkollave të mesme dhe fillore në Bujanoc dhe Preshevë kanë kaluar trajnimin dhe janë regjistruar në shkollat e mesme dhe fakultetet e tyre të preferuar. Një nga pjesëmarrësit e trajnimit ka regjistruar fakultetin në Novi Sad dhe është bërë bursist i Shërbimit të trupit Koordinues.

- **Panairi i potencialeve investive** – Në bashkëpunim me Odën Ekonomike të Sërbisë, në prill është



organizuar Panairi i potencialeve investive të komunave Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë. Në Panair, komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, kanë prezentuar potencialet e veta ekonomike dhe kanë njoftuar të gjithë me mundësitë e investimeve në këto tri komuna. Pjesëmarrësit e Panairit nga këto komuna kanë pasur mundësinë që në mënyrë të drejtpërdrejt të bisedojnë me investuesit potencial – fondet investuese, institucionet lokale, organet shtetërore, subjektet e tjera ekonomike dhe bankat.



Në panair janë prezentuar 22 ndërmarrje, prej të cilave nga tetë kanë qenë nga Bujanoci dhe Presheva dhe gjashtë nga Medvegja. Panairin e kanë hapur ministresha për zhvillim regional dhe administrim lokal Verica Kallanoviq, kryetari i Trupit Koordinues profesori Zoran Stankoviq, shefi i delegacionit të Unionit European në Sërbi Vensan Dezher, ambasadori i SHBA-ve Majkëll Kirbi, shefi i misionit të OSBE-së Peter Burkhard dhe kryetari i Odës Ekonomike të Sërbisë Zhelko Sertiq.

Përgjat Panairit është organizuar edhe tryezë e rrumbullakët me temë “Programi i mbështetjes shtetërore ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme – burimet e finansimit” në të cilin kanë marrë pjesë përfaqësuesit e Ministrisë finansave dhe ekonomisë, Ministrisë së zhvillimit regional dhe administrimit lokal, Agjensionit nacional për zhvillim regional dhe Agjensionit për investime të huja dhe promovimit të eksportit të Republikës së Sërbisë. Përfaqësuesit e këtyre institucioneve kanë vërtetuar angazhimin për zhvillim ekonomik dhe fuqizimin e këtyre komunave të pazhvilluara në jug të Sërbisë.

- **Gjenerata e tretë e praktikantëve e trajnuar në organet shtetërore** – Zyra për të drejtat e njeriut dhe pakicave, me mbështetjen e ambasadës së Britanisë Madhe dhe ambasadës së Mbretërisë Holandës, ka organizuar ciklin e tretë të “Programit të praktikës për pjesëtar të pakicave nacionale në institucionet shtetërore të Republikës së Sërbisë”.

Përgjat gjashtë muajve praktikantët kanë qenë të angazhuar në shumë aktivitete duke përfshirë vizitën e Kuvendit popullor, trajnime të shumta, vizita të institucioneve të ndryshme dhe pjesmarrja në organizime të sferës kulturore. Dy praktikant të përkatësisë shqiptare nga komuna e Bujanocit dhe Preshevës kanë punuar gjashtë muaj në zyrat e Shërbimit të trupit Koordinues në Beograd. Në punën e tyre gjashtëmujore sebashku me mentorën e tyre, kanë arrit të përfitojn njohuri të shumta të rëndësishme për avancimin e tyre profesional në të ardhmen.

- **Shërbimi i trupit Koordinues ka siguruar mjetet për sanimin nga vërshimet** – Shërbimi i trupit Koordinues nga rezervat buxhetore ka siguruar mjetet për sanimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet në komunën e Preshevës dhe Bujanocit në vlerë prej 7.300.000,00 dinarë. Në mars të këtij viti një numër i madhë i ekonomive familjare në komunën e Preshevës dhe Bujanocit kanë përjetuar dëme nga vërshimet. Sipas raporteve të ekipeve komunale për vlersimin e dëmeve gjithsejt janë dëmtuar 158 ekonomi familjare në këto dy komuna. Me sigurimin e këtyre mjeteve, qytetarët e Preshevës dhe Bujanocit kanë siguruar ndihmën e nevojshme materiale për kushte adekuate për jetesë.
- **Shkolla e gjuhës serbe për të rinjtë e bashkësisë shqiptare** – Shërbimi i trupit Koordinues, me mbështetjen e ambasadës së Britanisë Madhe, në nëntor të vitit 2012 ka filluar me realizimin e shkollës së *Gjuhës serbe* pa pagesë. Orët e gjuhës serbe janë organizuar për të rinjtë shqiptarë, të moshave prej 15 deri në 30 vjet, nga komuna e Bujanocit dhe Preshevës. Për *Shkollën e gjuhës serbe* janë paraqitur 310 pjesmarrës, ndërsa 250 prej tyre kanë kaluar edhe provimin përfundimtar. Katër profesoresha të gjuhës serbe, me ndihmën e asistentëve lokal nga bashkësia shqiptare, përgjat shtatë muajve kanë punuar në avancimin dhe përmirsimin e gjuhës serbe të pjesmarrësve.



Gjat realizimit të *Shkollës së gjuhës serbe* pjesmarrësit kanë pasur mundësin që të bisedojn me ambasadorin e Britanisë së Madhe E.T. Majkëll Devenport dhe kryetarin e Trupit Koordinues profesorin Zoran Stanković. Pjesmarrësit e projektit në këtë takim kanë treguar njohurit e arritura përgjat orëve të mbajtura.

Në maj të vitit 2013, pjesmarrësit e *Shkollës së gjuhës serbe* kanë kaluar provimin final, pas së cilit u janë ndarë diplomat nga instituti “Bozhidar Axhija” nga Beogradi. Pjesmarrësve të *Shkollës së gjuhës serbe* diplomat u ka dorzuar kryetari i Trupit Koordinues profesori Zoran Stanković, kryetari i Këshillit nacional Shqipëtar, Galip Beqiri, dhe kryeshefi për veprimtari shoqërore pranë komunës së Bujanocit, Bajram Fejzullahu.

*Shkolla e gjuhës serbe* është një projekt i rëndësishëm i cili mundëson të rinjëve shqiptarë të mësojnë gjuhën serbe, që prezenton edhe një hap më afër integritit të tyre.

- **Materniteti jashtëspitalor në Preshevë** – Projekti më i rëndësishëm në sferën e shëndetësisë është ndërtimi i maternitetit jashtëspitalor në Preshevë, që njëherit ka qenë edhe njëra prej kërkesave themelore të Shqiptarëve nga mbyllja e këtij institucioni në vitin 1989.



Faza e parë e punimeve në maternitetin jashtëspitalor në Preshevë ka përfunduar në dhjetor të vitit 2012. Për fazën e dytë të punimeve në ndërtimin e objektit janë siguruar mjetet nga buxheti: Shërbimi i trupit Koordinues (10.300.000,00 dinarë), Ministria e

shëndetësisë (15.00.000,00 dinarë), Ministria e zhvillimit regional dhe administrimit lokal (10.00.000,00 dinarë) dhe komuna e Preshevës (23.157.879,90 dinarë).


Për qëllim të themelimit të listës së aparaturës e cila është e nevojshme për punën e këtij institucioni, Shërbimi i trupit Koordinues ka organizuar vizitën në maternitetet jashtëspitalore në Llazarevc dhe Rumë. Përveq përfaqësuesve të Shërbimit të trupit Koordinues, në vizitë të materniteteve kanë qenë edhe kryetari i komës së Preshevës, zëvendës kryetari i komunës dhe drejtori i shtëpisë së shëndetit. Programi EU Progres ka siguruar pjesën më të madhe të aparaturës për këtë institucion në vlerë prej 250.000,00 euro. Komuna e Preshevës ka kryer procedurën e prokurimit publik për aparaturën tjetër të nevojshme për maternitetin. Me një shumë prej afër 9 milion dinarëve, Shërbimi i trupit Koordinues nëpërmjet mjeteve transferuese ka marrë pjesë në furnizimin e maternitetit me paisje.

Duke e marrë parasysh që në këto momente në Preshevë ka mungesë të mjekëve specialistë, është arritur marrëveshja që të realizohet një bashkëpunim me Qendrën shëndetsore nga Vranja. Mjekët nga shtëpia e shëndetit të Preshevës do të shkojnë në trajnim në qendrën spitalore në Vranjë, ndërsa, në periudhën fillestare, mjekët nga Vranja do të i realizojnë lindjet në Preshevë. Ministria e shëndetësisë do të mundësojë specializimin për tre të punësuar në Shtëpinë e shëndetit në Preshevë, në mënyrë që në të ardhmen ky institucion të kryejë në mënyrë të pamvarun procesin e lindjeve.

- **Bisedimet me përfaqësuesit e partive politike shqiptare** – Pas dy takimeve të mbajtura ndërmjet kryetarit të Trupit Koordinues, profesorit Zoran Stanković, dhe përfaqësuesëve të partive politike shqiptare, në të cilët është biseduar rreth problemeve të Shqiptarëve në jug të Sërbisë, liderët shqiptarë kanë propozuar temat për bisedime me përfaqësuesit e Qeverisë së Republikës së Sërbisë. Qeveria e Republikës së Sërbisë më 4 qershorë ka aprovuar Konkluzionin me anë të së cilës është aprovuar Raporti nga mbledhja e kryetarit të Trupit Koordinues dhe përfaqësuesëve të partive politike shqiptare. Me këtë, Qeveria ka pranuar bisedimet rreth shtatë temave të propozuara nga

liderët shqiptarë. Qeveria i ka dhënë mbështetje të plot Trupit Koordinues dhe profesorit Stanković që të udhëheq këtë proces të bisedimeve dhe të koordinoj takimet. Trembëdhjet ministritë janë inkuadruar në këtë proces, ndërsa në emër të secilës ministri për bisedime janë angazhuar sekretarë shtetërorë dhe/ose ndihmës ministra.

Zëvendëskryeministri i parë Aleksandar Vučić, më vonë edhe kryeministri Ivica Dačić kanë biseduar me përfaqësuesit e partive politike shqiptare, me çka edhe është vërtetuar përkushtimi i Qeverisë për zgjidhjen e problemeve në jug të Sërbisë. Bisedimet ndërmjet kryetarit të Qeverisë së Republikës së Sërbisë dhe liderëve të partive politike shqiptare kanë përfunduar me marrëveshje



që çdo tre muaj të analizohen rezultatet e masava të marra. Pas takimit me kryeministrin, me propozim të Trupit Koordinues, janë mbajtur dy takime përgaditore. Atëkohë është propozuar dinamika dhe rrjedha e bisedimeve dhe rradhitja e temave rreth të cilave do të bisedohet.

Është rënë dakord që në mbledhjen e parë të bisedohet rreth problemeve nga sfera e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale. Në lidhje me këtë, Trupi Koordinues ka organizuar një takim në tetorë, me ç'rast ministresha e

shëndetësisë Sllavica Gjukiq Dejanović ka vizituar Preshevën dhe ka biseduar me liderët politik shqiptarë rreth të gjitha problemeve që i përkasin kompetencave të ministrisë së shëndetësisë. Është rënë dakord që deri në prill të vitit 2014 të përfundoj ndërtimi i maternitetit jashtëspitalor në Preshevë, që është njëra ndër kërkesat e Shqiptarëve qysh nga viti 1989. Gjithashtu, në afatin e përmendur, do të realizohen edhe kërkesat e tjera të Shqiptarëve e që i përkasin Ministrisë së shëndetësisë. Mbledhja ka qenë mjaft konstruktive, është vlersuar si mbledhje shumë pozitive nga ministresha e shëndetësisë, Trupi Koordinues, përfaqësuesit e partive politike shqiptare dhe bashkësia ndërkombëtare.

Tema e dytë e cila është hapur ka qenë nga pika 4, në lidhje me Ligjin mbi vendëndodhjen dhe rajonet e gjykatave dhe prokurorive. Sikur që ligji ishte në procedurë në tetor dhe nëntorë, ashtu edhe Trupi Koordinues, me kërkesë të liderëve të partive politike shqiptare ka organizuar takim në Bujanoc, në të cilin ka marrë pjesë edhe sekretari shtetërorë në Ministrinë e drejtësisë Negjo Jovanović. Sekretari shtetërorë e ka vizituar Bujanocin të hënë më 18 nëntorë dhe me përfaqësuesit e partive politike shqiptare ka biseduar rreth propozim Ligjit mbi vendëndodhjen e gjykatave dhe prokurorive të paraparë si në vijim: Gjykata për kundërvajtje në Vranjë me njësinë gjyqësorë në Bujanoc, Gjykata për Kundërvajtje në Preshevë, Gjykata Themelore në Bujanoc për territorin e komunës së Bujanocit dhe Preshevës, Gjykata e Lartë në Vranjë, Gjykata Ekonomike në Leskoc për territorin e komunës së Preshevës dhe Bujanocit dhe Prokuroria themelore Publike në Vranjë me njësi në Bujanoc.

Deputeti popullorë Riza Halimi ka dorzuar amendamente rreth propozim Ligjit mbi vendëndodhjen e gjykatave dhe prokurorive në bazë të cilave parashihej: Gjykata për Kundërvajtje në Bujanoc, Gjykata Themelore në Preshevë dhe njësinë gjyqësorë në Medvegjë, Prokuroria themelore Publike në Preshevë dhe Bujanoc, Gjykata e Lartë në Bujanoc, për territorin e komunës së Bujanocit dhe Preshevës dhe Prokuroria e lartë Publike në Bujanoc për territorin e komunës së Bujanocit dhe Preshevës. Në takim liderët e partive politike shqiptare kanë sqaruar kërkesat e tyre në lidhje me propozimin për rrjetin e gjykatave dhe prokurorive në Bujanoc dhe Preshevë, duke insistuar që të gjitha amendamentet e deputetit popullorë Riza Halimi të aprovohen.



Sekretari shtetërorë Jovanović ka spjeguar propozim ligjin e rim bi vendëndodhjen e gjykatave dhe prokurorive, duke potencuar që është realizuar në përputhshmëri me parimin e mundsimit të qasjes në drejtësi të të gjithë banorëve dhe që Bujanoci dhe Presheva kanë marrë më shumë me këtë ligj, duke e pasur parasysh faktin e regjionit multietnik. Ky princip është aprovuar në të gjitha komunat. Për këtë arsye edhe numri i Gjykatave Themelore është rritur nga 34 në 60. Përgjat propozimit të rrjetit të gjykatave është marrë parasysh infrastruktura rrugore, largësia nga gjykata e parë dhe të drejtat dhe liritë e pakicave nacionale. Kriteriumet bazë me të cilat ministria është drejtuar, siç ka thënë Jovanović, është numri i lëndëve në raport me numrin e gjykatësve.

Në mbledhje është përmendur që rezultatet e regjistrimit të vitit 2011 nuk kanë qenë kriteret bazë për definimin e rrjetit të gjykatave dhe prokurorive, që është edhe vërejtja kryesore e Shqiptarëve. Pas këtij takimi, edhe përshkak të çështjeve tjera, përfaqësuesit e partive politike Shqiptare kanë vendosur që të i ngrijnë bisedimet. Lidertë Shqiptarë i kanë dërguar letër kryeministrit të Republikës së Serbisë dhe zv kryeministrit të parë, prej të cilëve kanë kërkuar të deklarohen në lidhje të disa çështjeve, por më së shumti kur bëhet fjalë për rezultatet e regjistrimit të fundit të popullsisë. Vendimi mbi ndërprerjen e bisedimeve është marrë në prag të takimit me ministrin e arsimit, shkencës dhe teknologjisë i cili ishte i paraparë të mbahet më 26 nëntor.

- **Mjete të pakthyeshme për zhvillim ekonomikë për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegje** – Edhe këtë vitë Shërbimi i Trupit Koordinues ka siguruar mjete në vlerë prej 60 milion dinarëve për finansimin e projekteve ekonomike në bazë të së cilëve u jipet përkrahje dhe nxitet



zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe kooperativave bujqësore. Në konkurs janë ndarë 59.582.131,80 dinarë për nxitjen dhe zhvillimin e 22 ndërmarrjeve nga këto tri komuna. Në komunën e Preshevës janë ndarë mjete në vlerë prej 21.040.858,86 dinarëve për zhvillimin e 8 ndërmarrjeve, në komunën e Bujanocit vlera prej 26.959.141,14 dinarëve për zhvillimin e 10 ndërmarrjeve, ndërsa për 4 ndërmarrje të komunës së Medvegjës janë ndarë 11.582.131,80 dinarëve.

Ky është viti i dytë që Shërbimi i trupit Koordinues ndanë mjete të pakthyeshme për ndërmarrjet nga këto tri komuna. Në konkursin e vitit 2012, 15 ndërmarrje nga këto tri komunat kanë marrë 40 milion dinarë ndihmë të pakthyeshme, ndërsa janë punësuar deri në 40 punëtorë duke iu faliminderuar këtij programi.

Realizimi i programit për ndarjen e mjeteve për subvencione i përket interesit strategjik për komunën e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës. Rezultati i konkurseve të realizuara është rritja e numrit të të punësuarve, rifreskimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, e poashtu edhe të kooperativave bujqësore për një lidhje efikase me tregjet lokale, regjionale, nacionale dhe ndërkombëtare, përmirsimi i prodhimit me qëllim të rritjes ekonomike, avancimi i konkurrencës në tregun kombëtarë dhe ndërkombëtarë si dhe avancimi i prodhimit i kushtuar eksportit ose zëvendësimin e tij.

- **Paisje shkollore pa pagesë për nxënësit e shkollave fillore** – Pesë vite me radhë Shërbimi i trupit Koordinues siguron çanta shkollore dhe paisje për nxënësit e klasave të para të këtyre tri komunave. Kryetari i Trupit Koordinues, profesori, Zoran Stanković ka ndarë çantat dhe paisjet shkollore nxënësve në shkollat multietnike në fshatin Leran, Bilaç dhe Levosojë, shkolla këto në territoret e komunës së Bujanocit dhe Preshevës dhe i ka dëshiruar nxënësve suksese dhe fatë



përgjat shkollimit. Shërbimi i trupit Koordinues për çantat dhe paisjet shkollore për 1000 nxënës ka ndarë 804.602,40 dinarë.

- **Orë olimpike në Bujanoc** – Për fëmijet e komunës së Bujanocit është organizuar “Ora olimpike”, me qëllim të demonstrimit të faktit se sa është e rëndësishme marrja me sport, avancimi i aftësive dhe njohurisë, krijimi i shoqërisë dhe puna në ekip. Filloristët nga Bujanoci kanë marrë pjesë në pesë punëtori, me anë të së cilave krijohen vlerat olimpike: rëndësia e lojës, *fer pleji*, rrespekti, përsosmëria dhe atmosfera e bashkimit të shpirtit, trupit dhe mendjes dhe kanë mësuar që është e rëndësishme që çkado që bëjnë të japin gjithçka nga vetja dhe të besojn në ëndrrat e tyre. Fëmijët i kanë përshëndetur Vlade Divac, basketbollisti i njohur dhe kryetar i komitetit Olimpik, kryetari i Trupit Koordinues, profesori Zoran Stankoviq dhe kryetari i komunës së Bujanocit Nagip Arifi.

Orën olimpike e ka organizuar komiteti Olimpik dhe Foni për sport dhe olimpizëm në bashkëpunim me Shërbimin e trupit Koordinues dhe komunën e Bujanocit.

- **Bursat për nxënësit e shkollave të mesme** – Shërbimi i trupit Koordinues nxënësve të shkollave të mesme të tri komunave edhe këtë vitë i ka ndarë bursa. Bursën e kanë fituar 285 nxënës të shkollave të mesme edhe atë 190 nga Presheva, 73 nga Bujanoci dhe 22 nga Medvegja. Këto bursa kanë karakter social. Shuma mujore e një burse kapë 6.000,00 dinarë në muaj dhe u paguhet përgjat tërë vitit shkollos, nga shtatori deri në qershorë.

- **Shkolla e re e gjuhës serbe për të rinjtë e komunitetit shqiptar**



– Shërbimi i Trupit Koordinues edhe këtë vit ka organizuar Shkollën e gjuhës serbe për të rinjtë e komunitetit shqiptar nga komunat Preshevë dhe Bujanoc. Orët në Shkollën e gjuhës serbe do të organizohen nga tetori i vitit 2013 deri në prill të vitit 2014. Për gjithë kandidatët janë siguruar libra për mësim të gjuhës serbe. Mësimi zhvillohet dy herë në javë, gjatë vikendit, në hapësirat e Fakultetit Ekonomik në Bujanoc dhe në hapësirat e shkollës së

mesme teknike në Preshevë. Tri profesoreshat e shkollës së gjuhës serbe janë nga Novi Sadi, të cilat në konkurs janë zgjedhur që të organizojnë orët e gjuhës, duke u përpikur që të gjithëve kandidatëve të ia përmisojnë njohuritë e gjuhës serbe. Për këtë do të kenë ndihmën e asistentëve nga komuniteti shqiptar.

Për dallim nga e kaluara, këtë vit kandidatët në testin fillestar kishin treguar njohuritë e arritura në gjuhën serbe. Prandaj, përveç grupit në të cilën grup mësimin e vijnë kandidatët të cilët janë në nivel fillestar të njohurive të gjuhës serbe (niveli 1 dhe niveli 2) në të dy komunat janë formuar grupe në të cilat orët i vijnë kandidatët me nivel më të lartë të njohurive (niveli mesëm 1).

Kandidatët e Shkollës së gjuhës serbe janë kryesisht nxënësit e shkollave të mesme, mirëpo është vërejtur edhe një numër i madh i studentëve të paraleles të Fakultetit Ekonomik në Bujanoc, fakulteteve tjera si dhe atyreve të cilët kanë kryer shkollimin.

Numri i kandidatëve të paraqitur për mësim të gjuhës serbe edhe këtë vit ka kaluar pritjet e Shërbimit të Trupit Koordinues. Ky është edhe një fakt tjetër se të rinjtë nga komuniteti shqiptar janë të motivuar që ta flasin gjuhën e rrethit ku jetojnë. Është një numër i madh i atyreve të cilët vitin e kaluar kanë ndjekur Shkollën e gjuhës serbe dhe dëshirojnë që ti rrisin njohuritë e arritura.

Inciativën e Shërbimit të Trupit Koordinues, me të cilën të rinjtë shqiptar arrijnë njohuri në gjuhës serbe, e përkrah ambasada e Britanisë së Madhe.

- **Bordi i palëve të interesuara** – Me propozimin e Fakultetit Ekonomik dhe Zyrës të komisarit të lartë për pakicat kombëtare është formuar *Bordi i palëve të interesuara*, detyrë e të cilit është të jep rekomandime për qëllim të përmisimit të kualitetit arsimor në paralelen e Fakultetit Ekonomik në Bujanoc. Këtë trup e përbëjnë përfaqësuesit e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Zhvillimit Teknologjik, Shërbimi i Trupit Koordinues, Fakulteti Ekonomik i Suboticës, komuna e Bujanocit, Këshilli Nacionali i Shqiptarëve, Zyra e komesarit të lartë për pakicat kombëtare, misioni i OSBE-së, Delegacioni i UE-së në Republikës e Serbisë dhe grupi i Miqëve të jugut të Serbisë. Mbajtja e ligjeratave nga kualiteti i lartë në paralelet e Fakultetit Ekonomik në Bujanoc është njëri ndër prioritetet e gjithë palëve të përfshira në procesin e krijimit të kushteve të rritjes së arsimimit më të lartë në jug të Serbisë.

Takimi i parë i *Bordit të palëve të interesuara* është mbajtur në tetor, me rastin e vizitës së komesarës së lartë për pakicat kombëtare shkëlqësisë së saj, Astrit Tors, Republikës së Serbisë. Në takim është shprehur gadishmëria e gjithë pjesëmarrësve në procesin që të sigurohen kushtet e nevojshme për funksionimin punës pa pengesë të paraleles në Bujanoc dhe që ti sigurohet studentëve studim i mëtutjeshëm. Me propozim të shefit të Delegacionit të UE-së, shkëlqësisë së tij, Majkëll Devenport, program i EU Progresit do të përpiloj *Studimin e fizibilitetit* në të cilin do të specifikohen drejtimet e mëtutjeshme për një zhvillim të nevojshëm të këtij institucioni të lartë arsimor. Të gjithë të pranishmit kanë përkrahur dhe kanë treguar dëshirë që të jenë pjesë gjatë krijimit të *Studimit*. Rezultatet preliminare të *Studimit* do të prezentohen në takimin e ardhshëm të *Bordit të palëve të interesuara* dhe do të paraqiten publikut përmes internetit.

- **Gjenerata e re e praktikantëve në Beograd** – Zyra e Shërbimit të Trupit Koordinues në Beograd, për tre vite rradhazi merrë pjesë në „Programin e praktikës për të rinjtë e komuniteteve pakice“. Prej nëntorit të vitit 2013 deri në prill të vitit 2014, dy praktikante nga komuniteti shqiptarë nga komuna e Bujanocit dhe Medvegjës do të arrijnë njohuri dhe aftësi të reja. Projektin e realizon Zyra për të drejtat e njeriut dhe pakicave me ndihëm e ambasadës së Britanisë së Madhe, ambasadës së Mbretërisë së Holandës, misionit të OSBE-së në Serbi dhe agjencionit suedez për zhvillim ndërkombëtar SIDA.

- **Është shënuar përvjetori i punës së paraleles të Fakultetit Ekonomik të Suboticës në Bujanoc**- Shërbimi i Trupit Koordinues dhe Fakulteti Ekonomik i Suboticës solemnisht e kanë shënuar fillin e punës të vitit të tretë të Fakultetit Ekonomik në Bujanoc.




Në këtë ngjarje kanë marrë pjesë profesor Zoran Stanković, kryetari i Trupit Koordinues Nenad Vunjak, dekan i Fakultetit Ekonomik, Miroslav Vesković, rektor i Univerzitetit të Novi Sadit, Nagip Arifi, kryetar i komunës së Bujanocit, Vullnet Ahmeti, rektor në Univerzitetin e Tetovës, Muhedin Fijulanin, sekretari shtetëror në Ministrinë e Arsimit shkencës dhe zhvillimit teknologjik, Majkëll Devenport, shef i Delegacionit të UE-së, Peter Burkhard, shef i misionit të OSBE-së në Serbi dhe Galip Beqiri, kryetar i Këshillit Nacional të Shqiptarëve.

Këtë vit janë regjistruar 109 student. Numri i studentëve të cilët financohen nga buxheti i Republikës së Serbisë është 69. Mësimi në paralelen e Fakultetit Ekonomik në Bujanoc është në dy gjuhët, ndërsa ligjëruesit janë nga Subotica dhe Tetova.

Shërbimi i Trupit Koordinues ka siguruar përkthimin dhe shtypjen e teksteve për studentët e vitit të tretë dhe katërt nga komuniteti shqiptarë. Për nevojat e ndërtimit të ndërtesës së paraleles, ky trup ka ndarë mjete për ndërtimin projektit kryesor dhe urbanistik.

• **Me sukses kanë kaluar edhe planifikimet e aktiviteteve për vitin e ardhshëm –**



Shërbimi i Trupit Koordinues ka analizuar punën dhe rezultatet e arritura gjatë vitit 2013 dhe ka përgaditur propozim planin e aktiviteteve për vitin e ardhshëm.

Në vitin 2014 do të fillojë punën materniteti në Preshevë dhe do të fillojë ndërtimi i ndërtesës së paraleles së Fakultetit Ekonomik të Suboticës në Bujanoc. Shërbimi i Trupit Koordinues do të vazhdojë të nxisë zhvillimin ekonomik të këtyre tri komunave duke i shpërnda mjete të pakthyshme ndërmarrësve. Gjatë vitit 2014, do të vazhdojmë me aktivitetet për sigurimin e teksteve të cilat tekste do të shërbejnë për

ligjerim në gjuhën shqipe dhe do të organizohen disa aktivitete në fushën e kulturës. Në vitin 2014, është planifikuar vazhdimi i bisedimeve me liderër e partive politike shqiptare nga jugu i Serbisë për temat e mbetura të përfshira në Raportin e Qeverisë.

*Shërbimi i trupit Koordinues i  
Qeverisë së Republikës së Serbisë  
për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë  
Tel: 011 21 20 906  
011 21 20 907  
Faks: 011 21 20 909  
E-mail: [office@kt.gov.rs](mailto:office@kt.gov.rs)  
faqja e internetit: [www.kt.gov.rs](http://www.kt.gov.rs)*